

03/12/2025

# Hidhet shorti për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të

# Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2026

Galeria

Në Institucionin e Presidentit të Republikës u hodh sot shorti për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2026. Procedura e hedhjes së shortit u ndoq nga Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Bajram Begaj, dhe i gjithë procesi iu nënshtrua plotësisht parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit, përfshirë dhe transmetimin *live* që mundësoi ndjekjen e drejtpërdrejtë nga tëgjitha institucionet, subjektet e interesuara dhe publiku.

Në hedhjen e shortit ishin të pranishëm përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si edhe përfaqësues nga OPDATdhe Delegacioni Evropian në Shqipëri.

Rezultati pas hedhjes së shortit:

Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2026:

LISTA ME ANËTARËT E KED-së 2026

1. Fiona Papajorgji, Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese

2. Marjana Semini, Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese

3. Ilir Panda, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë (sipas ligjit, Ilir Panda është dhe Kryetar i ri i KED-së)

4. Alfred Progonati, Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme

5. Ornela Naqellari, Gjyqtar në Gjykatat e Apelit

6. Iliriana Olldashi, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit

7. Altin Binaj, Prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

8. Afërdita Ndoj, Prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

9. Klodiana Veizi, Gjyqtar nga Gjykata Administrative



LISTA ME ANËTARËT ZËVENDËSUES TË KED-së 2026

1. Gent Ibrahimi, Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese

2. Valbon Çekrezi, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë

3. Anila Leka, Prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme

4. Selvie Gjoçaj, Gjyqtar në Gjykatat e Apelit

5. Arben Qosja, Prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

6. Bezart Kaçkini, Gjyqtar nga Gjykata Administrative





## Shkruaj Presidentit


**Adresa:**
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
**Email:**
info@president.al


©2024 President.al